



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 833 / prot.  
3

Vlorë, më 14.05.2021

VENDIM

Nr. 23, datë 14. 05. 2021

PËR  
PËRCAKTIMIN E BURIMIT TË FINANCIMIT TË PROGRAMEVE TË REJA TË  
MIRATUARA NGA BA, PËR VITIN AKADEMIK 2021- 2022

Në mbështetje të nenit 49, pika 1, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr. 7, datë 31. 03. 2021 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 1, datë 14. 01. 2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbyllje e institucionit të arsimit të lartë, degët e tyre, njësitë kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", të ndryshuar, shkresës nr. 2443 prot, datë 30. 04. 2021 të MASR, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 14. 05. 2021.

VENDOSI:

1. Të miratojë bashkëfinancimin nga të ardhurat e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe nga Buxheti i Shtetit, për programet e reja aplikuar për vitin 2021- 2022, si më poshtë:

Lloji i programit	Emërtimi	Vendimi i BA
Program 2 vjeçar	Akuakulturë dhe higjenë e produkteve të peshkimit	Nr. 7, datë 13. 02. 2020
Program 2 vjeçar	Teknik laboratorit kimik	Nr. 45, datë 29. 10. 2020
Master profesional	Mësuesi në Histori-Gjeografi	Nr. 22, datë 14. 05. 2021
Bachelor	Media, komunikim dhe trashëgimi kulturore, me profilet: Gazetari dhe Multimedia; Trashëgimi kulturore	Nr. 21, datë 14. 05. 2021

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.